




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 09.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **06.03.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.I. SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K., Rruga "Idriz Seferi", 60000, Gjilan** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Livadhet e Arapit"**, me nr. të prokurimit **651-22-11197-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GI 651 022 100 521** nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.I. SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K., Rruga "Idriz Seferi", 60000, Gjilan**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Livadhet e Arapit"**, me nr. të prokurimit **651-22-11197-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GI 651 022 100 521** e dt. **06.03.2023** kundër **Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.03.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
- 2. AK - Komuna e Gjilanit Vazhdon sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.03.2023.**
- 3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.I. SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K., Rruga "Idriz Seferi", 60000, Gjilan, me datë **06.03.2023**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Livadhet e Arapit"**, me nr. të prokurimit **651-22-11197-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GI 651 022 100 521**.

Autoriteti Kontraktues me datë **09.03.2023** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sipas pretendimit tuaj nr. **I** - se kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të dt. 11.01.2023 një OE konkretisht **OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe se AK e ka Aprovuar pjesërisht dhe lëndën e kthyer në rivlersim.**

Pasi që lënda është kthyer në rishqyrtim ju me dt. 01.03.2023 keni publikuar përsëri Njoftimin mbi Vendimin tuaj, ku e keni rekomanduar për kontratë **OE "TALI SH.P.K.**, ndërsa neve na keni shpallur si tenderues të pasuksesshëm, ndërsa OE i cili kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim **"Company Zuka Commerce" Sh.p.k., përsëri e keni shpallur si tenderues të eliminuar.**

Përderi sa OE tani I rekomanduar që të shpërblehet me kontratë nuk kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Vendimit për eliminimin e të njejtit ashtu siç parashihet në nenin 108/A të LPP-së, atëherë rezultoni se i njejtë është pale pa interes në këtë aktivitet të prokurimit conform nenit 4 Parag.1.26 të LPP-së, ku është përcaktuar se: "1.26 Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstaur se: me dt. 19.01.2023 sipas kërkesë për rishqyrtim nga ana e OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., Metush Krasniqi nr.135, 60 000, GJILAN, ka marr Vendim që kërkesa e lartë cekur të Aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlersim.

Dhe gjatë rivlersimit të ofertave AK ka konstatur se OE "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., Metush Krasniqi nr.135, 60 000, GJILAN, nuk i përmbush kërkesat e AK sipas DT dhe njoftimit për kontratë, andaj i njejtë është shpallur tenderues i eliminuar, ndërsa OE "TALI SH.P.K., E Bujanovcit, 60000, GJILAN, ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ultë, andaj shpallur si OE i suksesshëm, ndërsa ju si Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.I. SH.P.K.; MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K., Rruga "Idriz Seferi", 60000, Gjilan, keni ofruar ofertën tuaj në harmoni me kërkesat e AK sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë, mirëpo oferta juaj ka qenë e pasuksesshme për arsye se çmimi i ofruar ka qenë më i lartë. Kriteri i DT dhe Njoftimit për Kontratë ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të ultë.

Pasi që lënda është kthyer në rivlersim, AK ka vlerësuar gjitha ofertat, dhe ka vendosur sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.03.2023.

Sipas pretendimit tuaj nr. **II** - Se me dt.02.03.2023 kemi kërkuar qasje në dokumentacionet e OE "TALI SH.P.K. dhe "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., kun a është mundësuar takimi, mirëpo që nuk na është lejuar qasje në dokumentet e OE të lartëcekur për shkak se të njejtit i kanë cilësuar si secrete afariste dikumentet në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare dhe në dokumentet mbi mundësit teknike dhe profesionale, me arsyetimin se OE, mund të keqërdorin informtat e kompanisë tone. Përderi sa nuk na keni ofruar qasje në dokumentet e të njejtëve ju keni vepruar në këtë rast në kundërshtim em nenin 10 dhe 11 të LPP-së sepse është dashur ta përgatitni versionin e pastruar të dokumentave dhe të mos aprovoni kërkesën e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër që I gjithë dokumentacioni në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare dhe në dokuemntet mbi mundësin teknike dhe profesionale të konsiderohen secrete afariste.

Ju si AK nuk e keni marrë parasysh fare kërkesën tonë të dt.02.03.2023 identifikuar me nr.Prot.05, ku kemi kërkuar që të përgatitni versionin e pastruar duke anashkaluar pjesët apo dokumentet të cilat mund të zbulonin secrete të kompanive në fjalë.

Ne kemi qenë të inetersuar ti shohim listëne kontratave për tri vitet e fundit, listën e paisjeve, stafin profesional, dokumentet këto të cilat nuk mundë të keqpërdoren nga asnje OE, pasi që siç edhe dihet të

gjitha kontratat që nënshkruen nga OE mund të shihen edhe online, pra janë publike dhe transparente, prandaj nuk është dashur të aprohet kërkesa e OE të rekomanduar për kontratë që i gjithë dokumentacioni të cilësohet si sekret afarist.

Ne dyshojm se të njejtit OE nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD dhe të njoftimit për kontratë.

Në pamundësi të shikimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër ne duhet të ngritim pretendimet ankimore duke u bazuar në dyshime.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka përbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale:

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (ndërtim I ulet) gjatë 3 vitet e fundit. duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat. Në një vlerë prej jo me pak se 433.000,00 €.

Dëshmia 1 Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

OE i rekomanduar për kontratë dyshojm se nuk e plotëson kërkesën e alrtëcekur pasi që nuk ka prezentuar dëshmi të mjaftueshme që arrin të plotësoj velrën e kërkuar të kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit. Në këtë dyshim tonin e keni vërtetuar edhe vet ju ku në Njoftimin mbi Vendimin e kaluar e keni shpallur si tenderues të eliminuar të njejtin dhe i njejtin nuk e ka kundërshtuar këtë arsye të eliminimit përmes kërkesës për rishqyrtim.


AK – Kuvendi Komunal Gjilan, pas pranimit të kërkesës tuaj të dt. 02.03.2023 për qasje në dokumente, ju ka njoftuar se ju lejohet qasja në dokumentet e kërkuara, ku me dt. 03.03.2023 përfaqësuesi i juaj ka qenë në kohën e caktuar të AK, ku gjatë takimit është njoftuar se OE “ Tali “ SH.P.K, dhe OE “Company Zuka Commerce “ në këtë procedurë të prokurimit e kanë plotësuar Aneksin nr.3 të DT - Infomacioneve sekrete afariste - ku është bërë identifikimi i Infomacioneve sekrete afariste. – Kapacitetet Ekonomike dhe Financiare sipas nenit 68 si dhe aftësia Teknike dhe /ose profesionale sipas nenit 69 të LPP-së. Si dëshmi për këtë juve si OE i interesuar për qasje në dokumentet zyrtare i’u është dhënë dëshmia e Aneksit nr.3 të cilën e ka plotësuar OE “ Tali “ SH.P.K, dhe OE “Company Zuka Commerce “.

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë “ TALI SH.P.K., E Bujanovcit, 60000, GJILAN, sa i përket kërkesave mbi mundësit teknike dhe profesionale më saktësisht Listës së kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit – ka dorëzuar listën e kontratave, për të cilën për të qenë më transparente dhe më të sigurtë AK ka kërkuar edhe nga Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturë që të vërtetohen të njejtat.

Këto të fundit janë vërtetuar edhe nga Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturë, dhe për AK janë të pranueshme dhe në harmoni me kërkesat e AK.

Sipas pretendimit tuaj nr. III. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse dyshojm se i njejtin nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të DT. në lidhje me stafin profesional të kërkuar. Ne dyshojm se stafi i prezentuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e posedon përvojën e kërkuar në DT dhe gjithashtu dyshojm se i njejtin nuk i ka prezentuar dëshmit e noterizuar, ashtu siç është specifikuar në kërkesën nr.2 të DT.

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë



“TALI SH.P.K., E Bujanovcit, 60000, GJILAN, sa i përketë kërkesave mbi mundësit teknike dhe profesionale më saktësisht lidhur me Kërkesën nr. 2 sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë ku kërkesë e AK ka qenë:

Kërkesa 2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj staf profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme :

- a) 1 (Një) Menaxher te projektit - Inxhinier i diplomuari Ndërtimtarisë, 3 vite përvojë pune pas diplomimit . Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku nje (1) projekt nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi ,ose ndërtimi i rrugëve). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe pronari i kompanis.
- b) 1 (Një) Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë - 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi hidro) , si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve dhe strukturave . Minimum nje (1) projekte të udhëhequr në lëmin e kërkuar . Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe pronari i kompanis.
- c) 1 (Një) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me - 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum një (1) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe pronari i kompanis.
- e) 3 (tre) teknik të ndërtimtarisë me se paku 3 vite përvojë pune në realizimin e projekteve të ngjashme. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga Tekniket dhe pronari i kompanis.

Dëshmia e kërkuar:

Dëshmia 2 - Kontratat e punës ose parakontratat të noterizuara me inxhinierat , Diplomat e noterizuar nga vetë mbajtësit e saj, CV-te dhe Referenca për projekte të tilla qe e deshmojnë pervojën e punës te natyrës se ngjashme. Per punetoret lista e nënshkruar dhe vulosur nga kompania per kete projekt , bashkangjitur kontratat e rregulta te punës ose parakontratat per angazhim ne kete projekt.

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë “TALI SH.P.K., ka ofruar gjitha dëshmit e kërkuara që për AK janë pranueshme.

Sipas pretendimit tuaj nr. IV. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se dyshojm që nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të DT. sa i përketë paisjeve, ku është kërkuar “ Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit , Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “ Dëshmia 3. Lista e paisjeve duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga pronari i kompanis. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj), Marrëveshja duhet të jetë në emrin e këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar në prezencë të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Ne dyshojm se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartëcekur përkatësisht kërkesat nr. 13 Rimorkio sinjalizuese elektrike për paralajmërimin e punimeve në komunikacion (duke mos rrezikuar pjesëmarrësit në trafik) dhe kërkesën nr.14 Kompresor ajri min 7 bar.

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë “TALI SH.P.K., E Bujanovcit, 60000, GJILAN, lidhur me kërkesën e AK sipas DT në Aneksin nr.7 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm paisja sipas nr. Rendor 13. Rimorkio sinjalizuese elektrike për paralajmërimin e punimeve në komunikacion (duke mos rrezikuar pjesëmarrësit në trafik), ka ofruar dëshmi Dokumentin Unik Doganor i cili është dokument zyrtar i kontrolluar nga zyra doganore e destinacionit ZBD Merdare R 15216 i dt. 02/11/2022 që për AK mundë të konsiderohet

document i besueshëm dhe i pranueshëm, si dhe dëshmi Faturën e blerjes sipas nr: 49/2022 e dt. 02.12.2022 që dëshmon se mekanizmi i njejtë është Rimorkio sinjalizuese e përdorur për punime në rrugë, që është i përafërt, me kërkesën nr.13 të Aneksit 7 të DT. për Rimorkio sinjalizuese elektrike për paralajmërimin e punimeve në komunikacion (duke mos rrezikuar pjesëmarrësit në trafik).

Andaj, AK bazuar në atë që u cek më lartë AK ka vepruar sipas nenin 59 të LPP-së pika 4 ku parashihen devijimet e vogla, pasi që oferta e OE të rekomanduar që të shpërblehet me kontratë ka qenë e përgjegjshme me çmimin më të ulët në harmoni me Kërkesat e DT dhe Njoftimit për Kontratë.

Për kërkesën nr.14 Kompresor ajri min 7 bar ka ofruar dëshmi Kontratën – Faturën e blerjes nr.75/2007, NRB: 805881135 e dt.26.02.2007.

Sipas pretendimit tuaj nr. V - që ka të bëjë me Planin Dinamik për realizimin e projektit dhe dyshimet e juaja se OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë nuk e ka dorëzuar Planin Dinamik sipas kërkesës së DT – nuk qëndron për faktin se:

Kërkesë e AK sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë ka qenë:

**Kërkesa 4. OE duhet te ofroj plani dinamik per realizimin e projektit.
Dëshmia 4. Planit dinamik i nënshkruar dhe vulosur nga kompania.**

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se OE i rekomanduar që të shpërblehet për kontratë TALI SH.P.K., E Bujanovcit, 60000, GJILAN, ka dorëzuar Planin Dinamik të nënshkruar dhe të vulosur në harmoni me kërkesën nr. 4 të DT.

Sipas pretendimit tuaj nr. VI - Se pajtoheni me arsyet e eliminimit të OE "Company Zuka Commerce ", të cilat janë të evidentuara dhe të publikuara edhe në letrën standarte.

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, ka konstatuar se pasi që lënda është kthyer në rivlersim, AK ka vlerësuar ofertën e tij, dhe ka vendosur sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 01.03.2023.

Sipas pretendimit tuaj nr. VII – Duke u bazuar në dëshmit dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashu, AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë nuk jemi rekomanduar për kontratatë. Prag.1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që:

“ Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparent”.

Po ashtu ju si AK nuk keni pasur në konsiderat edhe Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se:

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka

vepruarë në mënyrë transparente.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT dhe Njoftimin për kontratë në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës ka shpërblyer me kontratë publike operatorin ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.

